



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

PJESA 2:	RREZIQET NË PUNË
Tema 2.2.	PLUHURI DHE AGJENTËT KIMIKË
Nën-tema 2.2.4.	PLUHURI
Ligji / rregulloret përkatëse:	<ul style="list-style-type: none">• Rregullore (MPMS) Nr.10/2017 për sigurinë dhe mbrojtjen shëndetësore e të punësuarve nga risqet që lidhen me agjentët kimikë në punë;• Rregullore (MPMS) Nr.04/2016 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë;• Rregullore (MPMS) Nr.05/2016 për kërkesat minimale në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë të të punësuarve nga risqet e atmosferave shpërthyes.
Shkurtesa:	<ul style="list-style-type: none">• PPM – Pajisje Personale Mbrojtëse• MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Përdorimi i listës kontrolluese:	Nëse përgjigjeni “Po” në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni “Jo” bëni vërejtje që mund të këshilloni të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika kontrolli	Po	Jo	Vërejtje për zbatimin
	PARA VIZITËS NË LOKACION / VENDET E PUNËS			
	<ul style="list-style-type: none">* Përgatituni për vizitën në lokacion. Nëse nuk i mbani mend kërkesat tuaja të brendshme, udhëzimet për punën me pluhur, lexojini përsëri dokumentet për të qenë gati për vizitën në lokacion.* Pluhuri është i zakonshëm në shumë industri të tilla si prodhimi i tekstileve, bujqësia, prodhimi i mobiljeve, prodhimet kimike, operacionet e riciklimit, përpunimi i metaleve dhe trajtimi i ujërave të zeza. Shumë lloje të pluhurit mund të jenë të djegshme në kushtet e duhura, përfshirë pluhurin metalik, pluhurin e drurit, pluhurin plastik dhe pluhurat organike si sheqerin dhe letrën.* Përpara se të identifikoni rrezikun e pluhurit në vendet tuaja të punës, së pari duhet të identifikoni proceset që prodhojnë pluhur ose tym.			
	INSPEKTIMI I LOKACIONIT / VENDEVE TË PUNËS			

	<ul style="list-style-type: none"> * <i>Gjatë vizitës në lokacionin / vendin e punës kushtoni vëmendje nëse mjedisi i punës është i pastër, sistemi i ventilimit funksionon dhe mirëmbahet, nëse pluhuri i mbledhur asgjësohet siç duhet. Kushtojini vëmendje vetë procesit të punës.</i> * <i>Pluhuri mund të jetë një rezultat përfundimtar i proceseve të ndryshme teknologjike si dhe forma e shumë materialeve në këto procese. Nëse kompania përdor substanca të përbëra nga grimca të forta, pluhur dhe të lirshme, është e mundur që disa prej tyre të jenë edhe substanca kimike të rrezikshme. Klasa e rrezikut dhe etiketimi gjithashtu duhet të merren parasysh në vlerësimin e riskut, jo vetëm gjendja fizike. Një kategori tjetër është pluhuri dhe aerosolet që krijohen në operacione të ndryshme, për shembull sharrimi, shpimi, bluarja, saldimi, etj. Pluhuri në mjedisin e punës duhet të vlerësohet si një risk kimik.</i> * <i>Vëzhgoni procesin e asgjësimit të mbeturinave dhe sigurohuni që ndiqen procedurat standarde të operimit.</i> * <i>Kontrolloni nëse të punësuarit mbajnë PPM të përshtatshme. Ata duhet të jenë trajnuar për procedurat e emergjente.</i> * <i>Jepni shembullin tuaj, përdorni PPM-të në varësi të kimikateve dhe rreziqeve që ekzistojnë në lokacion / vendet e punës!</i> * <i>Mbani shënime për vendet e vëzhguara të punës dhe bëni fotografi të proceseve ku gjenerohet pluhuri. Kushtojini vëmendje shembujve të mirë dhe jo të mirë.</i> * <i>Bisedoni me të punësuarit, tregohuni miqësorë, shpjegoni dhe këshillojini ata për rregullat e përgjithshme të sigurisë në punë një një mjedis me pluhur.</i> * <i>Përfundoni inspektimin duke ofruar një rekomandim përfundimtar të sigurisë dhe fushat për përmirësim.</i> 			
1.	<p>A është i pastër mjedisi i punës në përgjithësi?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 6 <i>Pluhuri i dukshëm në gypa, sipërfaqe, parmakë etj., mund të tregojë praninë e pluhurit në ajër. Sidoqoftë, shumë grimca pluhuri janë tepër të imëta për të qenë të dukshme në kushte normale të ndriçimit.</i> <i>Shikojeni zonën e punës si tërësi. Kushtojini vëmendje nëse dyshemeja është pastruar ditët e fundit ose nëse sipërfaqet e pajisjeve janë të mbuluara me pluhur,</i></p>			







	<i>etj. Nëse kompania kryen përpunimin e drurit, tallashi duhet të mblidhet rregullisht dhe të vendoset në një vend të caktuar posaçërisht.</i>			
2.	<p>A është vendosur ventilim i mjaftueshëm që:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● siguron shikueshmëri të mirë të operatorit; ● parandalon vendosjen dhe akumulimin e pluhurit në dhomë; ● redukton përqendrimit e pluhurit; ● parandalon kalimin e kontaminuesve në zonat e afërta të punës apo mjedis? <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 7.2.2</p>			
3.	<p>A pastrohen mbetjet e pluhurit në intervale të rregullta dhe në zona që mund të anashkalohen normalisht (p.sh., sipër diçkaje)?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 6.2.5</p> <p><i>* Kontrolloni të gjitha vendet e punës ku shfaqet pluhuri në procesin teknologjik. Pyesni të punësuarit që punojnë atje sa shpesh bëjnë pastrimin e zonës së punës?</i></p>			
4.	<p>A ekzistojnë metoda të pastrimit për të minimizuar retë e pluhurit, veçanërisht kur janë të pranishme burimet e ndezjes?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Nenet 7.6.2, 7.8</p> <p><i>* Pyesni të gjithë të punësuarit si e bëjnë pastrimin. Të punësuarit duhet t'i dinë procedurat e sakta të pastrimit të përditshëm në vendin e punës. Pastrimi nuk duhet të bëhet me anë të brushës, ajrit të kompresuar ose ndonjë metodë tjetër që ngre pluhur, siç është fshesa e thatë, pasi kur pluhuri ngrihet në ajër duhet shumë kohë që grimcat e imëta të bien poshtë. Rekomandohet përdorimi i një fshese thithëse ose një metodë e lagësht për t'i mbajtur pastër dyshemetë dhe sipërfaqet.</i></p>			
5.	A janë aprovuar dhe përdoren fshesat thithëse për mbledhjen e pluhurit në lokacion?			

	<i>Praktikë e mirë</i>			
6.	<p>A është sistemi i grumbullimit të pluhurit i bërë tërësisht prej materialeve jo të paqëndrueshme?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Nenet 6.2, 7.2 <i>Kontrolloni materialin e gypit të grumbullimit të pluhurit.</i></p>			
7.	<p>A janë siguruar grumbulluesit e pluhurit dhe aspiratorët elektrikë për gërryes që përdoren në operacione që prodhojnë sasi të mëdha pluhuri?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Nenet 6.2, 7.2 <i>* Nëse ka gërryes, kontrolloni nëse kanë kolektorë pluhuri. Pyesni të punësuarit sa shpesh zbrazen kolektorët e pluhurit për pajisjet e veglave të dorës.</i></p>			
8.	<p>A janë të lidhura dhe të tokëzuara të gjitha makinat që prodhojnë pluhur, sistemet e gypave dhe mbledhësit e pluhurit për të ulur akumulimin e ngarkesave elektrike statike?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, Neni 4 <i>* Kontrolloni të gjitha vendet e punës ku gjenerohet pluhur gjatë procesit të punës dhe verifikoni nëse sistemi i grumbullimit të pluhurit është i tokëzuar.</i></p>			
9.	<p>A lejohet pirja e duhanit vetëm në zona të sigurta të specifikuara? A janë shënuar qartë zonat ku ndalohet pirja e duhanit shenjat “Ndalohet pirja e duhanit”?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 7.6 <i>* Pyesni të punësuarit nëse pinë duhan dhe nëse po, ku e bëjnë atë. A pinë duhan gjatë pastrimit?</i></p>			
10.	<p>A janë pajisur të punësuarit me PPM adekuate dhe të përshtatshme?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Nenet 6.2.2, 6.2.5, 7.7</p>			

	<ul style="list-style-type: none"> * Nëse ekziston ndonjë rrezik nga grimcat fluturuese, të punësuarit duhet të mbajnë syze mbrojtëse ose mbrojtje të fytyrës. * Nëse ekziston rreziku i dëmtimeve të syrit siç janë çarjet, gërryerjet, kontuzionet ose djegiet, nga të punësuarit kërkohet të mbajnë syze sigurie. * Nëse i punësuarit është i ekspozuar ndaj pluhurit, duhet të përdoren filtrat P1 ose P2, ose P3. * Kontrolloni sa shpesh i ndërrojnë të punësuarit maskat me filtër të pluhurit, nëse i kanë. <p><i>Shënim: PPM-të kur punoni me kimikate përfshijnë, por pa kufizim, pantallona të gjera, përparëse, këpucë, doreza, gota rezistente kimike, mbrojtje të fytyrës dhe respiratorë.</i></p>			
11.	<p>A janë shënjuar qartë zonat/detyrat e përcaktuara për përdorim të PPM-ve?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 10.3 Të shqyrtohet së bashku me pyetjen Nr.19</p>			
12.	<p>A janë të punësuarit të informuar/trajnuar pse duhet t'i përdorin PPM-të?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 10.1.3 Pyetni të punësuarit se çfarë PPM duhet të përdorin, kur dhe pse (p.sh. kur dhe pse duhet të përdorni maskën me filtër të pluhurit, ose kur iu duhen syze sigurie ose mbrojtje e fytyrës).</p>			
13.	<p>A ofrojnë dhomat e zhveshjes hapësira të veçanta ruajtjeje për veshjet personale? A ofrojnë dhomat e zhveshjes hapësira të veçanta ruajtjeje për veshjet mbrojtëse?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Nenet 6.2.1, 6.2.5, 7 Të punësuarit duhet të kenë dhoma të ndara për veshjet personale dhe për veshjet mbrojtëse.</p>			

14.	<p>Kur dreka hahet në lokacion, a hahet në zona ku nuk ka ekspozim ndaj materialeve toksike (përfshirë pluhurin, tymin e saldimit, mjegullën e vajit) apo rreziqet e tjera shëndetësore?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 6.2.5 Vëzhgoni nëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> * të punësuarit pinë, hanë në vendin e punës; * ndonjë paketim ushqimesh, ushqimi i papërfunduar ose gota janë të dukshme në vendin e punës, duke treguar që të punësuarit pinë dhe hanë në vendin e punës. 			
15.	<p>A janë shënuar objektet e disponueshme të ndihmës së parë?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 8</p> <ul style="list-style-type: none"> * Kontrolloni nëse mund t'i shihni shenjat e sigurisë për objektet e ndihmës së parë nga disa pika të lokacionit. Nëse nuk mund t'i shihni shenjat, pyesni punëtorët nëse e dinë ku ndodhen objektet e ndihmës së parë. * Kontrolloni nëse larja e syve dhe dushet janë në gjendje pune dhe lehtësisht të arritshme kur kërkohet. 			
	 Dushi i sigurisë	 Pastrues për sy		
INSPEKTIMI I DOKUMENTEVE NË ZYRË				
	<ul style="list-style-type: none"> * Takohuni me përfaqësuesit e menaxhmentit (nëse është e mundur) dhe/ose ekspertët për SSHP. * Shpjegoni vëzhgimet tuaja të mira dhe jo të mira nga vizita juaj në lokacion. * Në rastet e mangësive të vëzhguara, sqaroni situatën (psh. të punësuarit nuk e pastrojnë rregullisht vendin e punës, nuk përdorin ventilimin e shkarkimit), bëni rekomandime dhe plane për të përmirësuar situatën (p.sh. trajnimi i të punësuarve për përdorimin e duhur të PPM-ve). 			

	<p>* <i>Tregohuni miqësorë, sqaroni dhe këshillojini për detyrimet e tyre në lidhje me përdorimin dhe trajtimin e sigurt të kimikateve. Jepni shembuj të praktikës së mirë nëse është e mundur.</i></p>			
16.	<p>A përfshihen proceset e emetimit të pluhurit në vlerësimin e riskut në vendin e punës?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 5</p> <p>* <i>A e dini se ku, kur dhe pse ndodhin shkarkimet e pluhurit? Kontrolloni dokumentet e vlerësimit të riskut për të identifikuar nëse diçka ka ndryshuar ose është harruar.</i></p> <p>* <i>Kontrolloni a vlerësohet ekspozimi ndaj pluhurit sipas rrugës së hyrjes në trup (p.sh., nga frymëmarrja, gëlltitja, thithja përmes lëkurës), diskutoni me ekspertin për SSHP.</i></p>			
17.	<p>A janë marrë masa për të zvogëluar dhe parandaluar rreziqet e pluhurit?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Nenet 6, 7, 8</p> <p><i>Kontrolloni dokumentet e vlerësimit të riskut për të identifikuar nëse është kryer vlerësimi i masave të tjera parandaluese, diskutoni me ekspertin për SSHP.</i></p> <p><i>Verifikoni:</i></p> <p>* <i>a ekzistojnë procedura për situata të mundshme emergjente?</i></p> <p>* <i>a ka shenja të duhura sigurie në vendet e punës nëse është e nevojshme?</i></p> <p>* <i>a ka ventilim shkarkues nëse është i nevojshëm (a mirëmbahet rregullisht?)?</i></p>			
18.	<p>A përdoret sistemi i zbulimit të shkëndijave dhe supresionit të shpërthimeve në sistemin e kolektorit të pluhurit (ose masa paraprake të ngjashme)?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, Neni 4</p> <p>* <i>Kontrolloni specifikimet teknike të pajisjeve.</i></p> <p>* <i>Kontrolloni nëse pajisjet kanë shënimet e servisimit të rregullt, merrni dhe mbani një procesverbal me shkrim për secilin rast servisi.</i></p>			

19.	<p>A janë vendosur shenjat e sigurisë në përputhje me vlerësimin e riskut në vendin e punës?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 10.3 Rregullore (MPMS) Nr.04/2016</p>			
 Duhet të përdoret pajisje për mbrojtjen e syve	 Duhet të përdoret dorezat e sigurisë	 Duhet të përdoret pajisje për mbrojtjen e veshëve		
 Duhet të përdoren pajisje për frymëmarrje	 Duhet të vishen veshje mbrojtëse për tërë trupin	 Duhet të përdoren pajisje për mbrojtjen e fytyrës		
20.	<p>A i përfshijnë shënimet e trajnimit efektet shëndetësore, kontrollet, metodat e sigurta të punës dhe pajisjet/veshjet personale mbrojtëse?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 10 * <i>Kontrolloni faktet, verifikoni dokumentacionin.</i></p>			
21.	<p>A janë të trajnuar të punësuarit për punë të sigurt me lloje të ndryshme të pluhurit?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 10 <i>Kontrolloni dokumentet. Verifikoni nëse udhëzimet për sigurinë në punë përfshijnë udhëzime për trajtimin e emergjencave (p.sh. raste zjarri) dhe nëse të punësuarit janë të trajnuar t'i trajtojnë ato.</i></p>			

22.	<p>A janë kryer matje të pluhurit në ajrin e vendit të punës? A janë krahasuar rezultatet me vlerat kufitare të ekspozimit në punë?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 4 <i>Llojet e zakonshme të pluhurit në vendin e punës përfshijnë pluhur qymyrguri, pudër, kaolinë, klorur polivinil (PVC) dhe përzierje që përmbajnë silicë amorge, silikon, karbid silikoni, hir të karburantit të pulverizuar, gëlqere, gips, grafit, oksid alumini, dioksid titaniumi, pluhura të tjera minerale me përmbajtje të ulët kristaline të silicës dhe pluhurat organikë.</i> <i>Mos harroni, lloje të ndryshme pluhuri kanë vlera të ndryshme kufitare në punë (OEL).</i></p>			
23.	<p>Nëse vlerësimi i riskut konstaton se pluhuri (p.sh. tymi i saldimit, pluhuri i drurit, mjegulla e vajit, rëra, pluhuri prej letre etj.) mund të ketë një ndikim shëndetësor, a dërgohen të punësuarit në kontrolle të detyrueshme shëndetësore?</p> <p>Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 12 <i>Kontrolloni dokumentet. Kontrolli fillestar mjekësor i të punësuarve duhet të bëhet menjëherë pas punësimit. Kontrolli tjetër shëndetësor duhet të bëhet përputhje me rreziqet e kimikateve, kohëzgjatjen dhe nivelin e ekspozimit, si dhe shkallën e riskut.</i></p>			